



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 18 mars 2011
Nr. ref.: RK100/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 34/09

Parashtruesi

Imer Ibriqaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së
Kosovës, nr. 03V-115, të 4 qershorit 2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Imer Ibriqaj, nga Komorani, komuna e Gllogocit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03V-115, të 4 qershorit 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet që refuzimi i aplikacionit të tij për postin e Avokatit të Popullit ishte i padrejtë, duke shkelur kështu të drejtën e tij të garantuar me nenet 31 dhe 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata të vendosë lidhur me kërkesën e tij për masë të përkohshme.

Baza juridike

5. Neni 113 (7) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe nenet 53 dhe 54 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 27 korrik 2009, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me të cilën e kontestonte Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03V-115, të 4 qershorit 2009, për emërimin e Avokatit të Popullit, dhe dorëzoi një kërkesë në Gjykatë për masë të përkohshme.
7. Më 18 mars 2010, Kryetari e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova, Gjyljeta Mushkolaj dhe Almiro Rodrigues.
8. Më 27 maj 2010, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Kuvendin e Kosovës lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata i pranoi përgjigjet nga pala kundërshtarë më 3 qershor 2010 dhe më 6 qershor 2010.
9. Më 17 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Robert Carolan, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Almiro Rodrigues, Snezhana Botusharova dhe Gjyljeta Mushkolaj, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 13 mars 2010, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi aplikacionin e tij në Kuvend të Republikës së Kosovës pas shpalljes së konkursit për postin e Avokatit të Popullit.
11. Më 18 maj 2010, komisioni përzgjedhës ia dorëzoi raportin e vet Kuvendit të Kosovës, duke rekomanduar tre (3) kandidatë të mundshëm për postin e Avokatit të Popullit. Përveç raportit, komisioni përzgjedhës kishte bashkëngjitur edhe një listë me pikët e njëzet e tre (23) kandidatëve të intervistuar.
12. Parashtruesi i kërkesës, z. Imer Ibriqaj, nuk ishte ndër njëzet e tre (23) kandidatët që ishin ftuar për intervistë.

13. Kuvendi mbajti një seancë më 4 qershor 2010 me qëllim të përzgjedhjes së Avokatit të Popullit. Të njëjtën ditë, Kryetari i Kuvendit nxori Vendimin nr. 03V-115, me të cilin e emëroi z. Sami Kurteshi Avokat të Popullit të Republikës së Kosovës.
14. Parashtruesi i kërkesës ka parashtruar ankesë në Kuvendin e Kosovës dhe Zyrën Civile Ndërkombëtare lidhur me procesin e përzgjedhjes.
15. Më 29 korrik 2009, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurë administrative para Gjykatës Supreme. Rasti pret të zgjidhet në Gjykatën Supreme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Kuvendi i Kosovës e kishte refuzuar aplikacionin e tij dhe emërimi i Avokatit të tanishëm të Popullit ishte bërë në mënyrë të paligjshme, prandaj pretendon që ka pasur shkelje të nenit 45 të Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes].
17. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që rastet e tij në Gjykatën Supreme, të iniciuara më 29 korrik 2009, janë duke u zgatur qëllimisht, prandaj pretendon që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë].
18. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon kompensim monetar prej 550.000 € për dëme materiale dhe jo materiale.

Komenti i palës kundërshtare

19. Kuvendi i Republikës së Kosovës u përgjigj më 3 qershor 2010, duke theksuar që z. Ibrیقaj ishte eliminuar që në fazën e parë “për shkak të mospërbushjes së kushteve formale”.
20. Për më tepër, më 6 qershor 2010, përfaqësuesi ligjor i Kuvendit të Kosovës, Ministria e Drejtësisë, dorëzoi një letër shtesë në të cilën pohonte që procesi i përzgjedhjes ishte në përputhje me ligjin, duke bashkëngjitur edhe dokumentet e dosjes lidhur me procesin e përzgjedhjes së Avokatit të Popullit.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

21. Sipas nenit 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, fakteve të ofruara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vlerëson që parashtruesi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë se ekziston rasti *prima facie* në mënyrë që Gjykata të vendosë lidhur me kërkesën e tij për masë të përkohshme.
22. Gjykata konkludon që kërkesa për masë të përkohshme është e paargumentuar, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar argumente bindëse se mund të përballet me rrezik ose dëme të pariparueshme nëse kërkesa e tij për masë të përkohshme nuk miratohet.

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

23. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

dhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili thotë:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese gjersa rasti i tij pret të zgjidhet në Gjykatën Supreme.
26. Në këto rrethana, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e parakohshme dhe prandaj nuk mund të konsiderohet se i ka përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 113.7 të Kushtetutës.
27. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon se e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është shkelur pasi rasti i tij pret të zgjidhet në Gjykatën Supreme që nga 29 korriku 2009 (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
28. Prandaj, rezulton që kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Robert Carolan


Prof. Dr. Enver Hasani